



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MAJLINDA I. LLESHI
ADRESA SULEJMAN DELVINA
TEL: 692036636

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2313

Nr. koleksioni: 879

Tirane më 13/07/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053300106839605

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022053300106839605

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "MBM" SH.P.K)**

Sot, më datë 13.07 2022, para meje **Notere MAJLINDA I. LLESHI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, SULEJMAN DELVINA, u paraqiten personalisht:

SHITES:

Rolandi BAMLARI, atësia Ali, amësia Beke, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr: I. Qemali; Nd. P 9; H. Shk 2; Ap. Apt 9; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/09/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032326201 dhe nr. personal G10916033V, **ortak i shoqerise "MBM" shpk zoterues i 1 kuote qe perben 33% te kapitalit te shoqerise.**

Jep Pelqimin bashkeshortja e pales shitese

Valbona BAMLARI, atësia Petrit, amësia Drita, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr: I. Qemali, Pall 9 Katesh, Shk 2, Ap 9; Nd. P 9; H. Shk 2; Ap. Apt 9; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 10/09/1967, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035172046 dhe nr. personal G75910048I, .

BLERES:

Kadri MALJA, atësia Gani, amësia Zeliha, shtetas Shqiptar, lindur në Budull, Krujë dhe banues në TIRANË, me adresë E Saraçëve; Nd. 19; H. 6; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 30/04/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034266330 dhe nr. personal G70430158J.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "**MBM**" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATES

Shites, Rolandi Bamllari, ortak i shoqerise "MBM" shpk, ne kete kontrate transferon nepermjet shitjes, 1 kuote qe perben 33% te kapitalit themeltar te shoqerise "MBM" SHPK dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 80.190.000,00 leke, ne favor te personit te interesuar z. Kadri Malja, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Statutit te Shoqerise.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS



Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare 1.285.000 euro (nje milion e dyqind e tetedhjetë e pese mije euro), e konvertuar ne vleren në leke 151.077.450 sipas kursit te Bankes se Shqiperise date 13.07.2022, vlere te cilen pala blerese do ta likujdoje nepermjet Bankes Pro Credit Bank dhe Bankes OTP Bank dhe qe përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord.

Kjo vlere do te depozitohet nga pala blerese ne llogarine e noterit (Majlinda Lleshi), per tjetersim per nje afat 3 dite nga nenshkrimi i kontrates .

Menjehere me depozitim e fondeve ne llogarine e noterit, noteri do te transferoje vleren e plote 1.285.000 euro (nje milion e dyqind e tetedhjetë e pese mije euro), e konvertuar ne vleren ne leke 151.077.450 sipas kursit te Bankes se Shqiperise date 13.07.2022, ne llogarine e pales shiteses Z. Rolandi Bamllari prane Bankes OTP Bank sh.a.

Shitesi konfirmon faktin e mesiperme dhe deklaron se eshte dakort me menyren e likujdimit lidhur me cmimin e shitjes.

NENI 3

GARANCITE

- Bleresi eshte ne dijeni te plote te gjendjes financiare, proceseve juridike dhe te Urdherit per venien e mases se sekuestros konservative mbi aktivet e shoqerise (shkrese me date 05.07.2022, me nr dosje 669/3), si dhe cdo aspekt tjetër për sa i përket Shoqerise MBM sh.p.k.
- taksa qe buron nga diferenca midis vleres se shitjes se aksioneve dhe vleres nominale te tyre dhe te gjitha detyrimet e tjera financiare i mer persiper shoqeria MBM sh.p.k..
- me nenshkrimin e kesaj kontrate ortaku Rolandi Bamllari lirohet nga te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet ndaj te treteve.
- Shitesi posedon kuotat e lira nga cdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokure apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre.
- Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundërshtim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher, vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkruar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem
- Bleresit deklarojne se paraprakisht kane verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe kane dijeni te plote ne lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklarojne se njohin dhe pranon te blejne kuotat e mesiperme me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes me nenshkrimin e kesaj kontrate **bleresi z. Kadri Malja** behet zoterues i plote dhe i ligjshme e 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, qe perben 67 % te kapitalit themeltar te shoqerise "MBM" shpk,

Ortak te shoqerise behen :

- **Z. Kadri Malja**, zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, me vlere te pergjithshme 162.810.000.00, qe perben 67 % te kapitalit themeltar te shoqerise " MBM" shpk,
- **Z.Shpëtim Mansaku**, zoterues i plote dhe e ligjshme e 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme **80.190.000,00** leke, qe perben 33% te kapitalit themeltar te shoqerise " MBM" shpk,

Palet moren dijeni se te dhenat e tyre personale, une noteria do ti perdor ne zbatim te ligjit vetem per efekt te redaktimit te ketij akti. Perpunimi i ketyre te dhenave do te behet prej meje vetem ne respektim te plote dhe zbatimin rigoroz te dispozitave te ligjit 9887, date 10.03.2008, i ndryshuar "Per mbrojtjen e te dhenave personale.



NENI 4
ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë **MBM** me nr. 4, datë 13.07.2022,
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë **MBM**,
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 5
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

SHITES

Rolandi BAMLLARI

PALËT KONTRAKTUESE

BLERES

Kadri MALJA

Jep Pelqimin bashkeshortja e palës shitesë
Valbona BAMLLARI

Noter
MAJLINDA LLESHI

